



## se i Dërguari i Allahut ﷺ është pyetur për gjërat që më së shumti i fusin njerëzit në Xhenet, e në atë rast ka thënë: "Më së shumti në Xhenet fut devotshmëria ndaj Allahut dhe sjellja e mirë"

Ebu Hurerja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ është pyetur për gjërat që më së shumti i fusin njerëzit në Xhenet, e në atë rast ka thënë: "Më së shumti në Xhenet fut devotshmëria ndaj Allahut dhe sjellja e mirë." Gjithashtu është pyetur për gjërat që më së shumti i fusin njerëzit në Zjarr, e në atë rast ka thënë: "Goja dhe organi gjenital."

[Hasen-sahih] [Transmetojnë Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Ahmed]

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaroi se dy janë shkaqet më të mëdha që e fusin (besimtarin) në Xhenet, të cilat janë: Devotshmëria ndaj Allahut dhe sjellja e mirë. Devotshmëria ndaj Allahut (takvallëku) nënkupton që ndërmjet teje dhe dënimit të Allahut të vendosësh mburojë, gjë që arrihet duke i kryer urdhrat dhe duke iu shmangur ndalesave. Sjellja e mirë nënkupton që (besimtari) të jetë i buzëqeshur, të bëjë mirë dhe ta largojë pengesën (nga të tjerët). Dy shkaqe janë kryesoret që fusin në Zjarr, të cilat janë: Gjuha dhe organi gjenital. Prej mëkateve që i bën gjuha, janë: gënjeshtria, përgojimi, bartja e fjalëve e të tjera. Prej mëkateve që i bën organi gjenital janë: kurvëria, homoseksualizmi e të tjera.

<https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/5476>

